




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	DPKI
Nr. i fajl Broj stranica Nr. pages	03
Nr. Prot. BiProt. Prot Nu.	06-01/2917/22
Data Datum Date	20.07.2022



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenit 5, paragrafi 1 pika 1.5, nenit 18, paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë Kundër Korruptionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korruptionit me datë 19.07.2022, mori:

V E N D I M

- I. Mbylljet rasti me nr.AKK-DPK-06-558/22,për zyrtaren e lartë znj. Hajrije Morina, Drejtoresh e Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit, për shkak së është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë në rast se paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-DPK- 06-55822,që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë, znj. Hajrije Morina, Drejtoresh e Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit është zhvilluar procedura e paraparë për trajtimin e situatave të konfliktit të Interesit.

Ky rast ka filluar të trajtohet sipas detyrës zyrtare pas informacioneve të marra nga një palë e tretë me dyshimet e ngritura se Drejtoresha e Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit, është edhe Kryetare e Bordit të N.P “Iber Lepnc” ku bën monitorimin dhe licencimin e kësaj kompanie.

Agjencia sipas procedurës fillimisht ka verifikuar informacionin duke marrë edhe informacione nga institucionet tjera, duke përfshi edhe ARBK-në (Agjencia Për Regjistrimin e Bizneseve), e ku pastaj është identifikuar se zyrtarja Hajrije Morina, figuron të jetë pronar edhe person i autorizuar në bizneset privat me emër “Fashion Rose” SH.P.K, dhe Environet Mangment Systemes L.L.C-



Branch in Kosova. Funksione, të deklaruara edhe në formularin e deklarimit të pasurisë se bizneset në fjalë janë pasive.

Ajgencia kundër Korrupsionit, sipas procedurës së paraparë, fillimisht e ka njoftuar zyrtaren e lartë me një shkresë zyrtare për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit.

Pas pranimit të kësaj shkrese zyrtarja Hajrije Morina, nëpërmes telefonit ka kontaktuar me zyrtarët e AKK-së, dhe ka kërkuar qe të ketë një takim për tu njoftuar për rastin e iniciuar për të, e ku pastaj në zyrat e AKK-së është mbajtur edhe një takim informues, më këtë rast zyrtaret e AKK-së e kanë njoftuar atë me iniciimin e rastit, si dhe kanë kërkuar nga ajo të deklarohet se a mban funksionin e anëtares se Bordit në N.P “Iber Lepnc”, si dhe e kanë njoftuar se gjatë ushtrimit të funksionit si zyrtar i lartë publik, nuk mundet që njëkohësisht të ushtroj edhe funksion drejtues, respektivisht, menaxhues në biznesin privat, sepse kjo është e ndaluar me nen 13 (paragrafi 1) të Ligjit nr.06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit, në të cilën thuhet:

1. *Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë private, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit.*

Ndërsa me nenin 19 të Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit parashihen masat për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave. Dispozitat e nenit në fjalë përcaktojnë se:

1. *Në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari sipas rastit dhe rrëthanave:
 - 1.1. transferon interesin privat dhe të drejtat në drejtimin e ndërmarrjes sipas përcaktimeve të nenit 15 të këtij ligji; [...];
 - 1.3. jep dorëheqjen nga detyrat, funksionet ose veprimtaritë që janë në konflikt ose të papajtueshme me funksionin e tij publik;
 - 1.4. dorëhiqet nga funksioni publik.*

Gjatë këtij takimit të mbajtur me zyrtaren Hajrije Morina, të quajtur ndryshe edhe si ballafaqim i faktave, zyrtarja e lartë, ka deklaruar se në momentin që është njoftuar nga ana e Komisionit Parlamentar se është përzgjedhur si Drejtoresh e Autoritetit Rregulator për Shërbimet e Ujit, kam dorëzuar dorëheqjen time nga pozita e kryesues se Bordit në N.P “Iber Lepnc”, tek Ministria e Ekonomisë .

Ndërsa sa i përket të që nurit person i autorizuar ne bizneset private, ka deklaruar se bizneset në fjalë nuk janë aktive dhe nuk kanë pasur fare qarkullim, por do të marr veprime te menjëherëshme

qe të heq dore nga funksioni i personit të autorizuar në biznesin e saj privat me emër “Fashion Rose” SH.P.K.

Ndërsa sa i përket biznesit me emër Environet Mangment Systemes L.L.C-Branch in Kosova, ka deklaruar se nuk ka kontakt me pronaret e këtij biznesi, mirëpo do të mundohet të gjej mundësi për kontakt me pronaret e këtij biznesi, në mënyrë qe të kërkoj qe emri i saj mos të figuroj si person i autorizuar i këtij biznesi .

Në ndërkokë, Agjencia kundër Korrupsionit, ka pranuar njostimin, informacionin zyrtar nga zyrtarja Hajrie Morina, me të cilën dëshmohet se me datë 12.07.2021 ka dhen dorëheqje nga pozita e kryesueses se Bordit në N.P “Iber Lepnc”, si dhe dëshminë qe është ndryshuar emri i personit të autorizuar në biznesin me emër “Fashion Rose”.

Ndërsa sa i përket biznesit me emër “Evitonte Mangment Systemes L.L.C-Branch in Kosova”, na ka njostuar qe ketë çështje duhet t'a zgjedhë nëpërmjet gjykatës themelore, ashtu siç e kanë këshilluar edhe përfaqësuesit e ARBK-se, pasi qe nuk ka arritur të kontaktoj me pronaret e këtij biznesi, me gjithë atë ajo ka theksuar se do të bëj përpjekje qe në një afat sa me te shkurtër të sjell dokumentin zyrtar, për ndryshimet ne ketë biznes.

Pas komunikimit dhe përpjekjeve nga znj.Morina, kemi pranuar edhe njostimin tjeter zyrtar, ku na ka njostuar se ka ndërmarr veprimet e nevojshme dhe nuk figuron të jetë më person i autorizuar në biznes privat me emër “Evitonte Mangment Systemes L.L.C-Branch” (DPKI-06-2866/22).


Agjencia kundër Korrupsionit, konstaton se me veprimet e ndërmarra dhe dëshmitë e ofruara nga zyrtarja e lartë, Hajrije Morina, Drejtoresh e Autoritetit Rregulator për Shërbimet e Ujit, duke hequr dorë nga funksioni i personit të autorizuar ne bizneset private, janë krijuar rrethana të reja dhe është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18, paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit


Ylli Buleshkaj
